



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

## GJYKATA THEMELORE PEJË

---

AD/GJTHPE/.nr.13/24

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarit M.GJ, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga I.K, nga fshati Q..., K... e P..., pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 05.12.2024, mori këtë:

### A K T V E N D I M

**REFUZOHET** ankesa disiplinore e parashtruar nga I.K, nga fshati Q..., K... e P..., ndaj gjyqtarit M.GJ, **SI E PABAZUAR**.

### A r s y e t i m

Me datë 14.11.2024, Këshilli Gjyqësor i Kosovës konform nenit 9 par.1 pika 1.1 lidhur me par.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka përcjellë të Autoriteti Kompetent ankesën disiplinore të parashtruar nga I.K, nga fshati Q..., K... e P..., ndaj gjyqtarit M.GJ, me arsyetimin se gjyqtari ka bërë shkelje ligjore dhe moszbatim të ligjit lidhur me dëshmitë përkatësisht dokumentet që i ka dërguar për masën e përkohshme të sigurisë dhe gjyqtari ka refuzuar kërkesën për masë, i njëjti pretendon se janë disa njerëz me të njohshëm dhe më ndikim që të fshehin rastin, dhe thekson se në seancën e caktuar nuk është lejuar nga ana e sigurimit që të vazhdon për në seancë, i cili nuk ka pasur ftesën sepse ftesën e ka pasur avokatja, pastaj e kanë lejuar që të vazhdon dhe gjyqtari ka njoftuar se është përfunduar seanca dhe e radhës është caktuar me datën 09.09.2024. Tutje thekson se nuk është informuar për tre zarfet e dërguara me dëshmitë. Ndërsa pretendimet tjera kanë qenë të drejtuar drejtë falsifikimeve të dokumenteve të vitit 29.09.2014, të theksuar disa persona që kanë bashkëpunuar në drejtim të falsifikimit, ashtu që ka kërkuar që të hetohen të njëjtit, tutje ka theksuar se i është drejtuar kryetarit me ankesa dhe kërkesa, e sipas tij i njëjti asnjëherë nuk i është përgjigjur lidhur me kërkesat e parashtruara.

Pjesa tjetër e ankesës është e paqartë se në drejtim të kujt është e drejtuar ankesa dhe konkretisht se për çfarë shkeljesh bëhet fjalë, ka qenë e vështirë të kuptohet përmbajtja e ankesës pasi që fjalët janë të palidhura dhe me gabime drejtë shkrimore, andaj si rezultat i kësaj ka qenë e pamundur që të kuptohen pretendimet pasi që kanë qenë pa përmbajtje konkrete.

Me datë 18.11.2024, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të

Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruar nga I.K, nga fshati Q..., K... e P..., ndaj gjyqtarit M.GJ.

Gjyqtari M.GJ në deklaratën e tij të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës ka deklaruar se pranë kësaj gjykate me datën 01.04.2022 është parashtruar padia nga paditësi I.K, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit H.M, avokate në P..., ndaj të paditurve S.K. dhe R. N.-K, të dy nga fshati Z..., K...e P..., të cilët i përfaqëson sipas autorizimit A.N, avokat në P... Thekson se e autorizuar e paditësit në seancën e datës 07.10.2024 të shqyrtimit gjyqësor, në procesverbalin e kësaj seance e cila ka qenë e caktuar për dalje në teren e ka tërhequr padinë dhe propozimin për masën e përkohshme të sigurisë, paditësi dhe e autorizuar e tij si dhe i autorizuari i të paditurve, këtë procesverbal e kanë nënshkruar pa vërejtje. Pas plotësimit të kushteve ligjore të LPK-së, gjykata ka vendosur me aktvendimin C.nr.453/22, duke e konsideruar të tërhequr padinë dhe propozimin për masë e përkohshme të sigurisë. Të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse këtë aktvendim e kanë pranuar në mënyrë të rregullte, kundër këtij aktvendimi e autorizuar e paditësit ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, për piken e II të aktvendimit me datën 27.10.2024 ndërsa personalisht paditësi me datën 29.10.2024, po ashtu ka ushtruar ankesë ndaj këtij aktvendimi. Në deklaratën e tij thekson se pretendimet e parashtruesit të ankesës disiplinore janë pa përmbajtje konkrete, të paqarta dhe e njëjta përmban një përshkrim rrëfim paushallë dhe asgjë konkrete për të argumentuar pretendimet për shkelje disiplinore, të cilat i njëjti pretendon që i janë bërë nga ai si gjyqtari i lëndës.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj gjyqtarit M.GJ, së bashku me deklaratën e tij, ka gjetur se ankesa disiplinore është dukshëm joserioze dhe e pabazuar.

Pretendimi se gjyqtari ka bërë shkelje ligjore dhe moszbatim të ligjit lidhur me dëshmitë përkatësisht dokumentet që i ka dërguar për masën e përkohshme të sigurisë dhe gjyqtari ka refuzuar kërkesën për masë, këto veprime nuk hynë në domenin e shkeljeve disiplinore pasi që mbeten vlerësime të gjyqtarit sipas provave të prezantuar lidhur me caktimin apo refuzimin e masës, dhe këto pretendime nuk mund të jenë subjekt i vlerësimit në procedurën disiplinore pasi që nuk është kompetencë e autoritetit kompetentë vlerësimin e saktësisë dhe ligjshmërisë së vendimeve të gjyqtarëve, të njëjtat janë subjekt i vlerësimit të gjykatave të shkallëve më të larta.

Lidhur me pretendimet tjera se janë disa njerëz me të njohshëm dhe më ndikim që të fshehin rastin, autoriteti kompetent vlerësoj pretendimet e parashtruesit të ankesës disiplinore dhe gjeti se pretendimet në fjalë janë të paargumentuara me asnjë provë dhe shumë të përgjithësuara dhe si të tilla mbeten vetëm supozime të palës ankuese.

Pretendimet se në seancën e caktuar nuk është lejuar nga ana e sigurimit që të vazhdon për në seancë e më pastaj është lejuar, pretendimi se nuk është informuar për tre zarfet e dërguara me dëshmitë, këto nuk paraqesin shkak të argumentuar për të mbështetur dyshimin se gjyqtari ka kryer shkelje të natyrës disiplinore, pasi që i njëjti vetë në ankesën e tij deklaroi se më pastaj është lejuar që të vazhdon në seancën gjyqësore dhe gjyqtari e ka informuar se seanca ka përfunduar, vlen të

theksohet fakti se në seancën e datës 24.06.2024 ku i njëjti pretendon se nuk është lejuar, në këtë seancë ka prezantuar e autorizuar e paditësit këtu parashtruesit av. H.M, dhe të njëjtin procesverbal e ka nënshkruar pa vërejtje, andaj nga të lart cekurat nuk mund të vijim në përfundim se të njëjtit i është mohuar pjesëmarrja në seancën gjyqësore.

Ndërsa për pretendimet tjera që kanë qenë të drejtuar drejtë falsifikimeve të dokumenteve të vitit 29.09.2014, të theksuar disa persona që kanë bashkëpunuar në drejtim të falsifikimit, dhe kërkesës që të hetohen të njëjtit, të njëjtat pretendime të parashtruesit të ankesës duke mos qenë të argumentuar mbetet vetëm supozime të palës ankuese, në të kundërtën i njëjti ftohet që në rast se posedon prova që i mbështet dyshimet e tilla të njoftojë autoritet kompetente për zhvillim të hetimeve të mëtejme pasi që kryetari i gjykatës nuk është autoritet kompetent për zhvillimin apo hetimet penale drejtë falsifikimeve të dokumenteve.

Sa i përket pretendimit se i është drejtuar kryetarit me ankesa dhe kërkesa, e sipas tij asnjëherë nuk ka marr përgjigje lidhur me kërkesat e parashtruara, këto pretendimet janë tërësisht të pabazuar dhe nuk qëndrojnë, pasi që në vazhdimësi kryetari i gjykatës i është përgjigjur kërkesave të të njëjtit dhe atë përmes njoftimit GJ.A.nr.08/2024, të datës 11.01.2024 i është përgjigjur palës I.K duke e njoftuar për lëndën në fjalë, po të njëjtën datë është përcjellë edhe Njoftimi për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në të cilën është bashkëngjitur përgjigja e dërguar ushtruesit të kërkesës, përsëri me datën 14.06.2024 përmes njoftimit GJ.A.nr.299/24, të drejtuar për Këshilli Gjyqësor i Kosovës, është njoftuar se kërkesa e parashtruesit I.K është trajtuar dhe është njoftuar për të gjithë ecurinë procedurale të çështjes në lëndën C.nr.453/22. Tutje kryetari i gjykatës i është përgjigjur parashtruesit të ankesës përsëri me datën 16.09.2024 përmes përgjigjes GJ.A.nr.375/24, andaj pretendimet e tilla se kryetari i gjykatës nuk i është përgjigjur të njëjti nuk qëndrojnë pasi që kryetari i gjykatës trajton çdo parashtrësë të palëve, dhe në rastin konkret i është përgjigjur edhe parashtruesit të kësaj ankesë dëshmuar kjo me provat e cituar e më lartë.

Përfundimisht, autoriteti kompetent vlerëson se ankesa disiplinore në përgjithësi paraqet pakënaqësitë e shprehura nga parashtruesi i ankesës, ndaj vendimit të gjyqtarit me të cilin ka refuzuar caktimin e masës së përkohshme, veprime këto të cilat nuk hyjnë në domenin e shkeljeve të natyrës disiplinore. Andaj mbi bazën e të lartcekurave autoriteti kompetent gjeti se ankesa disiplinore mbështetet vetëm në supozime të cilat nuk janë mbështetë në asnjë provë të vetme dhe si të tilla nuk përbëjnë shkak të argumentuar për të mbështetur dyshimin se gjyqtari ka kryer shkelje të natyrës disiplinore.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenin 7 par.3 pika 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD/GJTHPE/.nr.13/24, me datë 05.12.2024.**

**Kryetari i Gjykatës**

---

**Armend Berisha**

*Vendimi i dorëzohet:*

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtarit M.GJ*
- 3. Parashtruesit të ankesës – I.K, nga fshati Q..., K... e P...*